

SPECIFIKIME TEKNIKE

PROJEKT RESTAURIMI

i Kishës së Ungjillizimit në Kozare - Kuçovë, monument kulture kategoria e parë

Përgatiti:

Ing.Eriseld Zyka



Berat 2023



KAPUTULLI 1

TË PËRGJITHSHME

1.1 Njësitë matëse

Në përgjithësi njësitë matëse të përdorura janë njësi metrike në mm, cm, m, m^2 , m^3 , copë, ml. Pika dhjetore janë të shkruara si “.

1.2. Grafiku i punimeve

- Sipërmarrësi duhet ti japë supervizorit një program të plotë duke i treguar rendin, procedurën dhe metodën sipas të cilave, ai propozon të punohet në sit deri në mbarim të punës.
- Informacioni që mban supervizori duhet të përshijë:
- Vizatime që tregojnë rregullimin e përgjithshëm të ambienteve të godinës dhe të ndonjë ndërtimi apo structure tjeter të përkohshme, të cilat ai i propozon për përdorim.
- Detaje të vendosje të strukturave të përkohshme
- Plane të tjera që ai propozon ti adoptojë për restaurimin dhe përfundimin e të gjitha punëve.
- Detaje të fuqisë punëtore të kualifikuar dhe jo të kualifikuar.
- Supervisionin e punimeve

1.3. Punime të gabuara

Cdo punë, që nuk është në përputhje me këto specifikime, duhet refuzuar dhe sipërmarrësi duhet të riparojë cdo defekt më shpenzimet e veta, sipas projektit.

1.4. Tabelat Informuese

Sipërmarrësi duhet të vendosë dy tabela, që të përbajnjë informacion të dhënë nga supervizori dhe të vendosen në vendet e caktuara nga ai. Fjalët duhet shkruar në mënyrë të tillë që të jenë të lexueshme nga një distancë prej 50 m. Gjuha e shkruar duhet të jetë në Shqip dhe Anglisht.

1.5. Autorizimet me shkrim

“Rregullat me shkrim” do ti referohen cdo dokumenti dhe letre të nënshkruar nga supervizori të dërguara sipërmarrësit që përbajnjë instruksione, udhëzime ose orientime për sipërmarrësin në mënyrë që ai të realizojë ekzekutimin e kësaj kontrate.

Fjalët e aprovuara, të drejtuara, të autorizuara, të kërkuara, të lejuara, të urdhëruara, të instruktuar, të emëruara, të konsideruara të nevojshme, urdhëresa ose jo(duke përfshirë emra, folje, dhe ndajfolje) të një rëndësie, do të kuptohen qe të aprovimet e shkruara, drejtimet, autorizimet, kërkesat, lejet, rregullat, instrukzionet, emërimet, urdhëresat e supervizorit që do të përdoren deri në daljen e një plani tjetër pune.

1.6 Kopjimi i vizatimeve (vizatimet siç është zbatuar)

Sipërmarrësi duhet të përgatisë vizatimet për të gjitha punimet “siç janë zbatuar faktikisht në terren. Gjatë zbatimit të punimeve në kantier, Sipërmarrësi do të ruajë gjithë informacionin e nevojshëm pér përgatitjen e “vizatimeve siç është zbatuar”. Do të shënojë në mënyrë të qartë vizatimet dhe të gjitha dokumentet e tjera të cilat mbulojnë punën e vazhdueshme të përfunduar. Këto vizatime do të azhornohen në mënyrë të vazhdueshme dhe t'i dorëzohen Supervizorit çdo muaj pér aprovim, pasi punimet të kenë përfunduar, së bashku me kopjen përfundimtare. Materiali mëjor do të dorëzohet në kopje letër.

Vizatimet e riproduara do të përfshijnë pozicionin dhe shtrirjen e të gjithë konstruksioneve mbajtëse të lëna gjatë gërmimeve dhe vendosjen ekzakte të të gjitha shërbimeve që janë ndeshur gjatë ndërtimit. Sipërmarrësi gjithashtu duhet të përgatisë seksionet e profilit gjatësor të rishikuar, pajisur me shënimet që tregojnë shtresat e tokës që hasen gjatë të gjitha punimeve të gërmimit.

Si përfundim, kopjet e riproduara të vizatimeve, “siç është zbatuar” do t'i dorëzohen Supervizorit pér aprovim. Vizatimet, “siç është zbatuar”, të aprovuara, do të bëhen pronë e punëdhënësit.

1.7 Vizatimet e punimeve të zbatuara dhe librezat e masave

Sipërmarrësi do t'i përgatisë dhe dorëzojë Supervizorit tre grupe të dokumentacioneve të punimeve sipas projektit. Ky material duhet të përmbajë një komplet të vizatimeve të projektit të zbatuar, vizatimet shtesë të bëra gjatë zbatimit të punimeve të aprovuara nga Supervizori, si edhe librezat e masave pér çdo volum pune.

1.8 Dorëzimet tek Supervizori

Sipërmarrësi duhet t'i dorëzojë Supervizorit pér çdo punimë shtesë, një vizatim të detajuar dhe puna duhet të fillojë vetëm pas aprovimit nga Supervizori.

Sipërmarrësi duhet të nënshkruajë propozime, detaje, skica, llogaritje, informacione, materiale, çetifikata testi, kurdo që të kerkohen nga Supervizori. Supervizori do të pranojë çdo dorëzim dhe nëse janë të përshtatshme do t'i përgjigjet kontraktorit në përputhje me çdo klauzolë përkatëse të kushteve të kontratës. Çdo pranim duhet bërë me data në marrëveshje me Supervizorin dhe duke iu referuar programit të aprovuar dhe kohës së nevojshme që i duhet Supervizorit pér të bërë këto

punime.

1.9 Mostrat

Sipërmarrësi duhet të sigurojë mostra, të etiketuara sipas të gjitha përshtatjeve, aksesorëve dhe tema të tjera që mund të kerkohen me të drejtë nga Supervizori për inspektim. Mostrat duhen dorëzuar në zyrën e Supervizorit.

1.10 Zëvendësimet

Zëvendësimi i materialeve të specifikuara do të bëhet vetëm me aprovimin e Mbikqyrësit të Punimeve. Nëse materiali i propozuar për t'u zëvendësuar është i njëjtë ose më i mirë se materialet e specifikuara; ose nëse materialet e specifikuara nuk mund të sillen në sheshin e ndërtimit në kohë për të perfunduar punimet e kontratës për shkak të kushteve jashtë kontrollit të Sipërmarrësit, që kjo të merret në konsideratë, kërkesa për zëvendësimin do të shoqërohet me një dokument dëshmi të cilësisë.

1.11 Dokumenta dhe vizatimet

Sipërmarrësi do të verifikojë të gjitha dimensionet, sasitë dhe detajet të treguara në Vizatimet, Grafikët, ose të dhëna të tjera dhe Punëdhënësi nuk do të mbajë përgjithësi për ndonjë mangësi ose mospërputhje të gjetur në to. Mos zbulimi ose korrigimi i gabimeve ose mospërputhjeve nuk do t'a lehtësojë Sipërmarrësin nga përgjegjësia për bërjen e llogarive të madhësive, llojeve dhe sasive të materialeve dhe pajisjeve të përfshira në punën që duhet bërë sipas Kontratës. Ai nuk do të lejohet të ketë avantazhe nga ndonjë gabim ose mospërputhje, ndërsa një udhëzim i poltë do të jepet nga Punëdhënësi nëse gabime të tilla ose mospërputhje do të zbulohen.

1.12 Fotografitë e sheshit të ndërtimit

Sipërmarrësi duhet të bëj fotografi me ngjyra sipas udhëzimeve të Mbikqyrësit të Punimeve në vendet e punës për të demostruar kushte e sheshit përpëra fillimit, procesin gjatë punës së ndërtimit dhe pas perfundimit të punimeve.

1.13 Bashkëpunimi në zonë

Ndërtimi do të bëhet në zona të kufizuara. Sipërmarrësi duhet të ketë veçanërisht kujdes në:

- a) Nevojën për të mirëmbajtur shërbimet ekzistuese dhe mundësinë e kalimit për punonjësit gjatë periudhës së ndërtimit.
- b) Prezencën e mundëshme të kontraktorëve të tjera në zonë me të cilët do të koordinohet puna.

E gjithë puna, do të bëhet në një mënyrë të tillë, që të lejojë hyrjen dhe përballimin e të gjitha pajisjeve të mundhsme për ndonjë Kontraktor tjetër dhe punëtorëve të tij si dhe stafin e

Punëdhënësit. Në përgatitjen e programit të tij të punës, Sipërmarrësi gjatë gjithë kohës do të bëjë llogari të plotë dhe do të kooperojë me programin e punës së Kontraktorëve të tjerë, në mënyrë që të shkaktojë një minimum interference me ta dhe me publikun.

1.14 Mbojtja e punës dhe e publikut

Sipërmarrësi do të marrë masa paraprake për mbrojtjen e punëtorëve të punësuar dhe të jëtës publike rreth sheshit të ndërtimit. Masat e sigurit paraprak të ligjeve të aplikushme, kodeve të ndërtesave dhe të ndërtimit do të respektohen. Makineritë, pajisjet dhe çdo rrezik do të kqyren ose eleminohen me përputhje me masat paraprake të sigurimit.

1.15 Mbrojtja e ambientit

Sipërmarrësi duhet të ndërmarrë të gjitha veprimet e mundëshme për të siguruar që ambienti lokal i sheshit të ruhet dhe që vijat e ujit, toka dhe ajri (duke përfshirë edhe zhurmat) të jenë të pastra nga ndotja për shkak të punimeve të kryera.

1.16. Transporti dhe magazinimi I materialev

Transporti I cdo materiali nga Sipërmarrësi do të bëhet me makina të përshtatëshme, të cilat kur të ngarkohen nuk shkaktojnë derdhje dhe e gjithë ngarkesa të jetë e siguruar. Ndonjë makinë që nuk plotëson këtë kërkesë ose ndonjë nga rregullat ose ligjet e qarkullimit do të hiqet nga kantjeri. Të gjitha materialet që sillen nga Sipërmarrësi, duhet të stivohen ose të magazinohen në mënyrë të përshtatshme per ti mbrojtur nga rrëshqitjet, dëmtimet, thyerjet, vjedhjet dhe në dizpozicion për ti kontrolluar nga Mbikëkqyrësi I Punimeve në cdo kohë.

Pastrimi përfundimtarë I zonës

Në përfundim të punës, sa herë që është e aplikueshme Sipërmarrësi duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skeleritë dhe ndërtimet e përkohëshme të cdo llojit dhe të lërë sheshin e lirë dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme

KAPUTULLI 2

PUNIME PRISHJE

2.1 Skeleritë

Cdo skeleri e kërkuar duhet skicuar në përshtatje me KTZ dhe STASH.Një skelator Kompetent dhe me eksperience duhet të marrë përsipër ngritjen e skelerive të çdo tipi që nevojiten. Sipërmarrësi duhet të sigurojë,që të gjitha rregullimet e nevojshme,që i janë kërkuar skelatorit të sigurojnë stabilitetin gjatë kryerjes së punës.Kujdes duhet treguar që ngarkesat e copërave të mbledhura mbi një skeleri,të mos kalojë ngarkesën për të cilën ato janë projektuar.Duhen marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalohet rënia e materialeve nga platform e skelës.Skeleritë duhet të jenë gjatë kohës së përdorimit të përshtashme për qellimin për të cilin do të përdoren dhe duhet të jenë konform të gjitha kushteve teknike.Në rastet e kryerjes punimeve në anët e rrugës ku ka kalime të kalimtarëve,ashtu edhe të makinave,duhet të merren masat të bëhet rrethimi i objektit,si dhe veshja e të gjithë skelerisë me rrjete mbrojtëse për të eliminuar rënien e materialeve dhe duke përfshirë shenjat sinjalizuese siaps kushteve të sigurimit teknik.

2.2 Supervizioni

Sipërmarrësi duhet të ngarkojë një person kompetent dhe me eksperience të trajnuar në llojin e punës për ngritjen e skelerive dhe mbikëqyrjen e punës për ngritjen e skelave në kantier.

2.3 Metoda e prishjes

Puna për prishje do të fillojë pasi të jenë stakuar energjia elektrike dhe rrjetet e tjera të instalimeve ekzistuese të objektit.

Metodat e prishjes së pjesëshme,duhet të jenë të tilla që pjesa e struktures që ka mbetur të sigurojë qendrueshmërinë e ndërtësës dhe të pjesëve që mbeten.Kur prishja e ndërtësës ose e elementeve të saj nuk mund të bëhet pa problem e ndarë nga pjesa e struktures do të përdoret një metode pune e përshtatshme.Elementët e drurit mund të hidhen nga lart vetem kur ato nuk paraqesin rrezik për pjesën tjeter të struktures.Kur prishen elementët duhen marrë masa për të mos rrezikuar elementet e tjërë konstruktive mbrojtës si dhe mos dëmtohen elementët e tjërë.Në përgjithësi puna e shkaterrimit duhet të fillojë duke hequr sa më shumë ngarkesa të panevojshme pa ndërhyrër në elementët bazë strukturalë.Punë të kujdeshme do të bëhen pë të hequr ngarkesat kryesore nën kushtet më të vështira.

2.4 Siguria në punë

Kontraktori duhet të sigurohet se vendi dhe pajisjet janë të një tipi dhe një standarti të përshtatshëm duke iu referuar vendit dhe llojit të punës që do të kryhet të siguruar nga një teknik competent dhe me experience të ruajtura në kushte të mira pune gjatë përdorimit.Gjatë punës prishëse të gjithë punëtprët duhet të vishen me veshje të përshtashme mbrojtëse ose mjete mbrojtëse si:helemta,szyze,mbrojtëse,mbrojtëse veshësh dhe bombola frymëmarrje.

KAPUTULLI 3
PUNIME RESTAURIMI

3.1 Restaurim mur guri llaç gëlqere 1:3

Përshkrimi:

Punimi përfshin restaurimin e murit të gurit ne pjesët ku është i dëmtuar me ripërdorimin e gurëve gëlqeror që ndodhen në vend, të cilët në fillim do mblidhen dhe sistemohen dhe më pas do rivendosen në vepër të punuar në mënyrë të çrregullt dhe në rreshta sub-horizontal me të njëjtën teknikë si muri ekzistues, ndërsa bërtama e përbërë nga po i njëjti material prej guri gëlqeror por me copa më të vogla dhe tëvendosura nëe mënyrë të çrregul:

Qëllimi:

Përmisimi dhe forcimi i murit të gurit.

Materialet e nevojshme:

Minerali (gur gëlqeror):

- Tipi: Gur gëlqeror
- Forma: Sipërfaqe e punuar në mënyrë të çrregullt dhe me cepa të thepisur (bozza)
- Dimensionet: Të madhësive të ndryshme.

Lidhësi:

- Raporti lidhës/inerte: 1/3
- Inerte: tipi: rërë silikate dhe gëlqerore ; granulometria: $d = 1-2 \text{ mm}$.

Karakteristikat mekanike të muraturës me gurë dhe llaç gëlqere:

Rezistenca në shtypje	$\sigma_{sh}=3 \text{ MPa}$
Moduli i elasticitetit	$E= 1500 \text{ MPa}$
Rezistenca në têrheqje	$\sigma_t=0.25 \text{ MPa}$
Rezistenca në prerje	$\tau=3 \text{ MPa}$

3.2 Fugatim muri (pastrim mekanik+larje me ujë+fugatim)

Përshkrimi:

Punimi përfshin vendosjen e llacit te fresket ne fugat e pastruara dhe te lagura te konstruksionit pavaresisht nga lartesia dhe forma, ne shtresa te njepasnjeshme prej 5 cm. sipas pershkrimit te projektit, d.m.th. do te vendoset shtresa pasardhese mbasi te kete bere presen shtresa e meparshme,

ndersa shtresa e fundit do te laget mire disa here dhe do te ferkohet me furce teli. Pastrimi i siperfaqes se muratures mbas perfundimit te procesit te fugatimit.

Qëllimi:

Përmirësimi i pamjes së murit

Materialet e nevojshme:

- Furcë teli
- Llac gëlqere 1:3
- Ujë
- Tuba plastikë

3.3 Konsolidim i kreut të murit me 1-2 rreshta gurë me llaç gëlqere 1:3

Përshkrimi:

Punimi përfshin konsolidimin e kreut të murit të gurit me 1-2 rreshta gurë në pjesët ku gurët janë të rrëzuar dhe dëmtuar me ripërdorimin e gurëve gëlqeror dhe rintegrimi i elementeve të gurit që mungojnë me material të ri (i njëjtë litotip) dhe llaç analog në rezistencë me originalin.

Materialet e nevojshme:

Minerali (gur gëlqeror):

- Tipi: Gur gëlqeror
- Forma: Sipërfaqe e punuar në mënyrë të çrrregullt dhe me cepa të thepisur (bozza)
- Dimensionet: Të madhësive të ndryshme.

Lidhësi:

- Raporti lidhës/inerte: 1/3

Inerte: tipi: rërë silikate dhe gëlqerore ; granulometria: $d = 1-2 \text{ mm}$.

3.4 Restaurim i çarjeve në mur guri me teknikën e injektimit (Pastrim i çarjes, larje ne ujë, injektim llaç gëlqere 1:3)

Përshkrimi:

Punimi përfshin restaurim e çarjeve në mur guri me teknikën e injektimit ku duhen të kryhen disa faza si më poshtë:

Fazat e zbatimit te injektimit për konsolidimin e muraturës ekzistuese.

1. Përgatitja e sipërfaqeve. (Pastrimi i fugave dhe larja me sfungjer të lagur).
2. Stukimi i fugave dhe të gjithë diskontinuiteteve, për të evitar rrjedhjen e mishelës nëpërmjet stukimit me lidhës koerent me mishelen e injektuar. Do përdoret një llaç me bazë të gëlqeres idraulike natyrale.
3. Realizimi i rrjetës së injektimit. Bëhet perforimi i paretit(2-4 vrima për m^2) me diametër $\varphi 1.5-2.5\text{cm}$.
4. Posicionimi i tubave ($\varphi 1-2 \text{ cm}$), me thellësi mesatare 50-60cm.
5. Insertimi me presion i mishelës me bazë të gëlqeres idraulike natyrale të hiperventiluar (presion 1,5 atm - 3 atm).
6. Heqja e tubave dhe stukimi i vrimave.

3.5 Zbërvitimi dhe restaurimi i çatisë

Restaurimi i çatisë do të behet duke ruajtur i njëjtë konfiguracion sic eshte paraqitur dhe ne projekt.

Qëllimi:

Përmirësimi i strukturës së çatisë

Materialet e nevojshme:

- Lëndë druri pishe katror e pastruar e cila mundet të jetë vendi ose importi.
- Dërrasa për mbulesë nën tjegulla: Petavrat duhet të jenë dërrasë pishe e stazhonuar për një kohë të gjatë me trashës 1.5-3 cm e cila mundet të jetë vendi ose importi.
- Tjegulla të lugëta vendi mundësish të përdorua por në gjendje të mirë me ngjyrën e vjetërisë ose po qenë të reja me ngjyrë të pështatshme me ato ekzistuese.
- Lënda drusore e gjitha të jetë e dizifktuar nga dëmtimet e mikro organizmave dhe brejtësit e ndryshëm.
- Letër katrama me trashësi 2mm-5mm për hidroizolimin e çatisë

3.8 Dritare Druri

Materialet ë perdonura:

Telajo dërrase (me seksione minimum 7 x 4 cm), mentesha dhe bllokues për tipe të ndryshëm dritaresh, kanate dritare, sopraluçë, doreza, xama (me trashësi 4 mm kur janë transparent dhe 6 mm kur janë të përforcuara me rrjet teli), listela druri të plotë, ngjitet transparent silikoni, bllokues dritaresh me zinxhir ose kompas.

Përshkrimi i punës:

Furnizim dhe vendosje dritare, përmasat e të cilës duhet të përcaktohen sipas projektit dhe realizohen nga prodhuesi në vendin e prodhimit, në dru pishe të stazhionuar, i imprenjuar e përbëre nga:

- një kontratelo dërrase (me gjerësi 3 cm, me madhësi sa kasa e dritares) që do të vendoset në mur me fasheta hukuri përparrë punimeve të suvatimit.
- një telajo dërrase (me seksione min 7x4cm) që do të vidohet në kontratelo pas kryerjes së suvatimit dhe bojatisjes. Në bazë të vizatimit të dritares së treguar në
- vizatim telajo do të pajiset me mentesha dhe bllokues për tipe të ndryshëm dritaresh, kanate dritare, superliça etj.
- shirita druri të plotë rreth perimetrit të dritares nga brenda, kur realizohen me paturë dhe nga brenda e jashtë në mungesë të paturës (dhëmbit)
- duke përfshirë bërjen e shpatullave të muraturës, si dhe çdo pajisje tjeter për mbarimin e punës në mënyrë preçize
- kampione të artikujve të propozuar, do ti paraqiten paraprakisht supervizorit për aprovim paraprak
- Dritare me kanate të pahapshëm të pajisur me: xama (me trashësi 4mm kur janë transparent, 6mm kur janë të përforuar me rrjete teli, ose me dopio xham), fiksuar
- me listela druri të plotë dhe ngjitet transparent silikoni, bllokues dritaresh me zinxhir ose kompas.

3.9 Dyert e jashtme prej druri

Dyert e jashtme prej druri të fortë pishe, të trajtuar me mbulesë mbrojtëse të drunjë do të përbëhen nga:

- Një kasë druri që fiksohet në mur me anë të ganxhave në formë thike prej çeliku përparrë suvatimit.(Gjerësia e kasës është 3 cm kurse gjerësia e saj sipas madhësisë së murit).
- Kasa binare për dyer me dhëmbë kur dyer janë me dhëmbë, me përmasa 7 x 5 cm, që mbërthehet në mur me ganxha dhe me llaç cimentoje.
- Një kornizë e kasës së drurit që fiksohet tek kasa e drurit e dhënë me sipër pas suvatimit dhe lyerjes. Për dyert e dhëna në Vizatimet Teknikë, korniza do të sigurohet
- me mentesha dhe ankerat e çelësit gjatë instalimit të pjesëve hapëse të derës.
- Kanatat hapëse me kornizë të drunjë (tamburate) janë me përmasa minimalisht 10 x 3 cm, pjesë horizontale dhe vertikale me të njëjtin seksion dhe me një lartësi të fundit prej 25 cm e cila është e ndarë me panele prej druri të trajtuar me mbulesë mbrojtëse të drunjë. Ajo është e kompletuar me mentesha (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse).

- Dy mbulesa të drunjta me trashësi 2-3 mm (një nga çdo anë). Përmasat do të jenë në varësi të madhësisë së derës së përcaktuar në projekt. Mbulesat mund të jenë të rrafshata ose me gdhendje.
- Bravat e sigurise së lartë së bashku me tre kopje çelësi tip sekret si dhe aksesorët e nevojshëm për instalimin e tyre. Bravat duhet të jenë tip **Cilindrike**, me shasi prej çeliku dhe kasë të fishekut të kyçjes në platë zinku, me cilindra tip kunjash. Bravat duhet të jenë të kyçshme në grup dhe të zbatueshme për çelësat sipas standartit.
- Mëtëshat (të paktën 3 për çdo pjesë hapëse) në tre pikë ankorimi.
- Dorezat përkatëse, me butonin shtytës në dorezën e brendshme që kyç dorezën e jashtme. Dorezat duhet të jenë plotësisht të kthyeshme nga ana e djathtë ose e majte e derës. Doreza e jashtme duhet të jetë gjithmonë aktive, ndërsa kthimi i dorezës së brendshme ose çelësit të bëjë ç'kyçjen e fishekut.

Pergatiti:

Ing. Eriseld Zyka

Dhimitra
Digitally signed by
Dhimitraq Niko
Date: 2023.03.30
14:33:38 +02'00'

b

